

## NJË VIZITË MBRESËLËNËSE

Me të drejtë Pejgamberi, alejhi's selam ka caktuar prej kushteve të vëllazërisë myslimane edhe vizitat ndërmjet tyre. Pikërisht mbi këtë parim, u organizuan edhe vizita të ndërsjella ndërmjet KBI-së në Vushtrri dhe disa shoqatave rinore turke. Më konkretisht, më 25 qershor 2010, KBI-Vushtrri, në krye me Kryetarin zt. Shemsi Rrahimin, Sekretarin zt. Sedat Islamin, Arkëtarin zt. Nasuf Bivolakun dhe Mual-limin zt. Sadik Hasanin, priti një delegacion prej 30 vetash, anëtarë të shoqatave rinore "Zinde Genclik" dhe "Asilder" . Fillimisht për ta u shtrua një dreke në ambientet e restaurantit *Ibri* në Mitrovicë e më pas u pritën edhe në lokalet e administratës së KBI-Vushtrri në Vushtrri.

Shemsi Rrahimi në një fjalim rasti, pasi që përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje, përveç tjerash, u fokusua edhe në kultivimin e raporteve ndemjet gjeneratave të reja duke nënvizuar porosinë që "nëse qeveritë e sotme kanë hequr vizat, ju atëherë le të mbetet misioni juaji të hiqni kufijtë", fjalë këto që ngjallen emocione të shumta tek rinia.

Pastaj fjalën e mori Kryesuesi i delegacionit Fatih Unal, i cili falënderoi shumë KBI-në e Vushtrrisë për pritjen e organizuar dhe shfrytëzoi rastin e bëri ftesë zyrtare për vizitë të Këshillit në Turqi.

Kjo vizitë e tyre është publikuar menjëherë në ueb faqen zyrtare të tyre ([http://www.asilder.org/haberler/yenihaber\\_75.html](http://www.asilder.org/haberler/yenihaber_75.html)).

